



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.582/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevci kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Shkëlqesa Jasiqi nga Gjermania, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.582/2021 i paraqitur nga Shkelqesa Jasiqi me vendbanim në Gjermani, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 01.09.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Shkelqesa Jasiqi me vendbanim në Gjermani, në të cilin pretendon se emri i saj dhe bashkëshortit të saj nuk është në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe thekson se nuk i din arsyet pse nuk janë në listë, pasi që nuk ka marrë asnjë njoftim nga KQZ-ja, edhe pse ka aplikuar në mënyrë të rregulltë gjatë afatit të aplikimit të shpallur nga KQZ-ja. Apelit ja ka bashkangjitur formularin e aplikimit për votim jashtë Kosovës, kopjen e dokumentit identifikues (pasaportën e Kosovës).

Me datë 01.09.2021 PZAP-i, ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ-së, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur me apelin e parashtruar nga pala ankuese deri me datë 01.09.2021 në ora 10:45.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se Shkelqesa Jasiqi nuk ka dërguar fare aplikacion për regjistrim për votim jashtë Kosovës, përgjatë periudhës së aplikimit për regjistrim (10 korrik - 18 gusht 2021).

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesja e apelit Shkelqesa Jasiqi gjatë periudhës për aplikim për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk ka dërguar fare aplikacion për regjistrim gjatë periudhës për aplikim, andaj ky apel nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: “çdo

person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: “votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil” dhe dispozita e nenit 3.3 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se:

3.3 Personi i cili ka për qëllim të hedhë votën për Votim Jashtë Kosovës...do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:

a) formularin për Aplikim/Regjistrim për votim jashtë Kosovës, kopja e së cilës është bashkangjitur si Shtojcë II, dhe,

b) dëshminë e dokumentacionit të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin e LZP-së dhe të bashkangjiten dokumentet e fotokopjuara siç janë të renditura në Shtojcën III. të kësaj rregulle,

Paneli, vlerëson se parashtresja e apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë dëshmi në lidhje me pretendimet e paraqitura si më lartë, edhe pse i njejtja në apel e ka bashkangjitur formularin për aplikim për votim jashtë Kosovës, të njëjtën nuk e ka dërguar në KQZ, gjatë kohës së aplikimit. Pra edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret ankuesi thënie të tij nuk i mbështetën në asnjë provë konkrete por se të njëjtat janë supozime dhe se këto pretendime ankuesja nuk i argumenton me asnjë provë.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se apeli i parashtuar nga Shkelqesa Jasiqi nuk është i bazuar në asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje e pretenduar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.582/2021 më datën 02.09.2021

Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevc



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.